Emri i projektit: Econimic Literacy Program/Programi mbi Edukimin Ekonomik
Implementuar nga: Instituti Alternativa Liberale - LAI, RMV
Partner: Economic Fundamentals Initiative - EFI, SHBA
Afati kohor: 01 Nëntor 2022 - 31 Tetor 2023

1. Objektivat

Qëllimi kryesor i projektit është të ndihmojë në ngritjen e standardeve të edukimit ekonomik në Maqedoninë e Veriut, duke promovuar dhe shpërndarë për lexuesit librin "EKONOMIKSI I MENDIMIT PRAKTIK", edicionin e rajonalizuar pa pagesë në të gjitha formatet, siç është përgatitur nga Iniciativa për Bazat Ekonomike (në tekstin e mëtejmë "EFI"), për audiencën më të gjerë të mundshme, organizimin e konferencës **#ECONLIT2023 "Ekonomiksi praktik: Shkathtësia e Nevojshme e Shekullit 21**" si dhe organizimin e **Olimpiadës Ekonomike 2023** për nxënës të shkollave të mesme në Maqedoninë e Veriut. E gjithë kjo organizohet në bashkepunim me **EFI-SHBA** (**Economics Fundamentals Initiative**, https://www.econfun.org/sq) dhe **Instituti per edukim ekonomike INEV** (https://inev.cz/en/) - Republika Çeke. Për këtë qëllim, LAI do të punojë me partnerët në vend për të maksimizuar ndikimin e projektit, duke shfrytëzuar ekspertizën e partnerëve në ofrimin e projekteve edukative dhe të kuptuarit e tyre për mjedisin operativ lokal.

2. Aktivitetet

Faza fillestare e promovimit të Ekonomiksit të Mendimit Praktik në Maqedoninë e Veriut është planifikuar të ndjekë disa faza:

(1) Konferenca #ECONLIT2023 - "Ekonomiksi praktik: Shkathtësia e nevojshme e shekullit 21"

Qëllimi i konferencës është të ofrojnë njohuri, mjete për të kuptuar botën e ekonomike dhe si të interpretohen ngjarjet që do të ndikojnë drejtpërdrejt ose indirekt tek të gjithë ne. Të pasurit një popullsi të edukuar ekonomikisht përmirëson aftësinë e publikut për të kuptuar dhe vlerësuar çështjet

kritike. Andaj, përmes kësaj konference do të tentohet të ngritet vetëdija mbi rëndësinë e edukimit ekonomik tek popullata e pergjithshme por edhe tek të rinjtë specifikisht.

(2) promovimi i versioneve tashmë të publikuara në anglisht dhe shqip në pjesën shqipfolëse të vendit dhe në universitetet dhe shkollat e mesme anglishtfolëse,

Aktiviteti I: Ngjarja Zyrtare e Lançimit

Aktiviteti II: Pajisja e bibliotekave të qytetit dhe universiteteve, si dhe shkollave të mesme me kopje të librit në shqip dhe anglisht

Aktiviteti III: Forume Diskutimi për të promovuar librin

Aktiviteti IV: Fushata në mediat sociale

(3) mundësia e botimit të librit në gjuhën maqedonase dhe promovimi i tij në nivel kombëtar, dhe

Aktiviteti V: Takime me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës dhe institucione të tjera përkatëse

(4) promovimi dhe trajnimi për gazetarët në një kontekst rajonal.

Aktiviteti VII: dukim ekonomik për Gazetarët që përdorin EMP (Punëtori e përbashkët rajonale)

(5) promovimi i edukimit ekonomik dhe financiar përmes organizimit të Olimpiadës Ekonomike në Maqedoninë e Veriut

Aktiviteti VIII: Zbatimi i Olimpiadës Ekonomike në raundet shkollore, rajonale dhe kombëtare

3. Olimpiada Ekonomike

Çka është Olimpiada ekonomike?

Shumë pak sisteme arsimore e njohin ndikimin e fuqishëm dhe të përjetshëm që një edukim i hershëm në ekonomi dhe financë mund të ketë në jetën e përditshme të secilit. Olimpiada e Ekonomisë është ideja e Institutit të Edukimit Ekonomik (INEV) në Republikën Çeke. Qëllimi i tij është të frymëzojë interesin për të mësuarit ekonomik tek adoleshentët. Sot Olimpiada e Ekonomisë zhvillohet në 13 vende. Në vitin 2023,

Instituti Alternativa Liberale në bashkëpunim me **Iniciativën e Bazave Ekonomike (EFI)** ka kënaqësinë të sjellë këtë garë edhe në Maqedoninë e Veriut, e cila është njëra nga 13 vendet ku do të mbahet kjo garë.

Si funksionon Olimpiada Ekonomike?

Olimpiada e Ekonomisë përbëhet nga 4 raunde dhe atë - shkollore, rajonale (opsionale), kombëtare dhe ndërkombëtare. 5 studentët më të mirë nga secili vend do të konkurrojnë në raundin ndërkombëtar. Olimpiada Ekonomike në Maqedoninë e Veriut do të organizohet në nivel kombëtar në një format dygjuhësh me opsionin për testimin e gjuhës angleze për komunitete të tjera përveç formatit shqip.

Konteksti

Në Maqedoninë e Veriut ka gjithsej 128 shkolla të mesme, duke përfshirë 11 shkolla të mesme private. Instituti Alternativa Liberale do të synojë që në vitin e parë të Olimpiadës Ekonomike në vend të marrin pjesë 10% e shkollave në vend, përkatësisht 12 shkolla. Të paktën gjysma e shkollave pjesëmarrëse duhet të jenë shkolla të mesme publike. Do të synojmë të kemi shkolla që përfaqësojnë secilin nga rajonet statistikore të vendit.

Raundet

i. Raundi shkollor

E hapur për nxënësit pa ndonjë dije ekonomi! Nxënësit i nënshtrohen një testi onlajn. Nxënësit më të mirë kalojnë në raundin tjetër. Çdo shkollë e mesme e regjistruar do të organizojë testimin e nivelit shkollor në përputhje me rregullat e OE. Në rastet kur shkollat nuk kanë kapacitete teknologjike për të organizuar testimin shkollor, nxënësve të regjistruar do t'u shpërndahet një provim me letër. Të dy llojet e testimit (testimi onlajn dhe në letër) do të kontrollohen nga një anëtar i ekipit organizues për të siguruar testim të drejtë.

Metoda e testimit: Testimi në këtë nivel do të ndjekë udhëzimet e OE dhe do të përdorë pyetjet e përgatitura të testimit

Afatet e raundit shkollor: 23-28 Shkurt 2023.

ii. Raundi regjional

Onlajn ose me prezencë fizike në varësi të situatës lokale. Niveli rajonal do të organizohet në 4 pika rajonale, duke bashkuar shkollat nga dy rajone. Testimi rajonal do të organizohet në bashkëpunim me universitetet e rajoneve përkatëse. Për nxënësit pjesëmarrës do të organizohet një seminar mbi edukimin ekonomik bazuar në kapitujt e Ekonomiskit të Mendimit Praktik, ndërsa një prezantim mbi EMP do të organizohet me mësuesit.

Metoda e testimit: një test me shkrim i bazuar në literaturën e ofruar do të administrohet në nivel rajonal, me një pyetje ese në lidhje me temën e seminarit.

Afatet e raundit regjional: 29 Prill 2023

iii. Raundi kombëtar

Një ngjarje njëditore për garuesit më të mirë të vendit. Gjithsej 40 nxënësit më të mirë do të marrin pjesë në nivel kombëtar të OE në Maqedoninë e Veriut (10 studentë nga secili nivel rajonal testohen, sipas disponueshmërisë). Testimi në nivel kombëtar do të organizohet në një nga universitetet partnere. Testimi në nivel kombëtar do të organizohet si një ngjarje gjithëditore me panele diskutimesh ndërmjet dy fazave të testimit. Përveç pjesëmarrësve të OE, të gjitha shkollat pjesëmarrëse, studentë të universiteteve dhe të tjerë do të mund të regjistrohen për të marrë pjesë në ngjarje. 5 fituesit e OE në Maqedoninë e Veriut do të shpallen në një ceremoni përmbyllëse të manifestimit.

Metoda e testimit: një test me shkrim nga materialet e ofruara do të administrohet për të gjithë studentët pjesëmarrës. 10 studentët më të mirë do t'i nënshtrohen një provimi me gojë me një juri prej 4 pedagogësh të ekonomisë nga 4 universitetet ku u zhvillua testimi rajonal.

Afatet e raundit kombëtar: 24 Qershorit 2023.

iv. Olimpiada Ndërkombëtare e Ekonomisë

5 nxënësit më të mirë nga çdo vend do të udhëtojnë në Bratislavë, Sllovaki, për të marrë pjesë në garëm ndërkombëtare të vitit 2023! Olimpiada mbahet në periudhë prej 2-4 ditë. Garuesit kanë mundësinë të bëjnë miq të rinj, të vizitojnë një vend të ri dhe të dëgjojnë e të mësojnë nga folësit prestigjioz të ftuar.

Shtetet pjesëmarrëse në Olimpiadën Ndërkombëtare të Ekonomiksit

Olimpiada e Ekonomiksit


Armenia


Bosnja dhe Hercegovina


Greqia


Gjorgjia


Hungaria


Kina


Kirgistani


Kosova


Maqedonia e Veriut


Polonia


Republika Çeke


Sllovakia


Ukraina